

Enkelejd ALIBEAJ



Datëlindja: 11.9.1973

Vendlindja: Seman, Fier

E-mail: Enkelejd.Alibeaj@parlament.al

Jetëshkrimi

Pas përfundimit të studimeve në Fakultetin e Drejtësisë në 1997, fitoi konkursin për të hyrë në Shkollën e Magjistraturës, duke u bërë kështu një nga të diplomuarit e brezit të parë të magistratëve, ku u diplomua “magjistër” me rezultate të shkëlqyera në vitin 2000.

Në vitet 1999–2000 ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, një nga gjykatat më të rëndësishme në Republikën e Shqipërisë. Në vitet 2000–2005 ushtroi profesionin e avokatit, ndërsa në vitet 2005–2007 ishte drejtor i Departamentit të Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Antikorrupsionit në Këshillin e Ministrave. Në vitet 2007–2009 ishte ministër i Drejtësisë në qeverinë e Republikës së Shqipërisë.

Është angazhuar në veprimtari akademike si lektor në lëndën “E drejta kushtetuese” në disa universitete dhe ka kontribuar në një sërë veprimtarish dhe botime akademike në fushën e së drejtës.

Ka marrë pjesë në një sërë seminaresh, konferencash, aktivitete dhe kurse trajnimi jashtë vendit që lidhen me të drejtën procedurale penale (Itali, Poloni), të drejtat e njeriut (Strasburg), reforma në gjyqësor (Bullgari) dhe në fushën e antikorrupsionit.

Në vitet 2000–2003 ka ushtruar detyrën e drejtorit ekzekutiv të Institutit të Studimeve Demokratike, një organizate jofitimprurëse në fushën e së drejtës me objekt të veprimtarisë së saj studimet në fushën e së drejtës dhe përgatitjen e legjislacionit. Gjithashtu është angazhuar nga OSBE-ja si një nga ekspertët më të mirë vendas në fushën e sistemeve dhe legjislacionit të zgjedhjeve.

